COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE

KKGjE(2022)4

Strasburg, 2 dhjetor 2022

KËSHILLI KONSULTATIV I GJYQTARËVE EVROPIANË (KKGjE)

Opinioni Nr. 25 (2022) i KKGjE-së

për lirinë e shprehjes së gjyqtarëve

Përmbajtje

I. Hyrje 3

II. Objekti dhe objektivi i Opinionit 3

III. Një vështrim mbi rregullat dhe praktikat e vendeve 4

IV. Parimet e përgjithshme 6

V. Kufizimet e lirisë së shprehjes/çështjet e diskutueshme 9

1. Deklaratat lidhur me mosmarrëveshjet gjyqësore 9

2. Deklaratat që lidhen me debatet publike 11

3. Deklaratat lidhur me çështjet me interes për gjyqësorin si institucion 11

4. Kritikat publike ndaj gjyqësorit/kolegëve gjyqtarë 12

5. Mandati politik aktiv/mandati i mëparshëm politik 12

VI. Mbrojtja e pavarësisë së gjyqësorit si detyrim ligjor dhe/ose etik i gjyqtarëve, shoqatave të gjyqtarëve dhe këshillave të gjyqësorit 13

VII. Detyrimi etik i gjyqtarëve për t'i shpjeguar publikut drejtësinë 14

VIII. Përdorimi i medias sociale nga gjyqtarët 15

1. Liria e shprehjes së gjyqtarëve në internet dhe jashtë tij 15

2. Hartimi i udhëzimit për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët 15

a) Përkufizimi i medias sociale 15

b) Zbatueshmëria e rregullit të përgjithshëm të vetëpërmbajtjes gjyqësore 16

c) Përshtatja e sjelljes gjyqësore me sfidat konkrete të komunikimit në median sociale 16

d) Propozimi i përdorimit transparent të medias sociale (me miratim) 17

e) Theksimi i rëndësisë së trajnimit të gjyqtarëve për përdorimin e medias sociale 17

IX. Rekomandime 18

I. Hyrje

1. Në përputhje me mandatin që i është dhënë nga Komiteti i Ministrave, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (KKGjE), ka përgatitur këtë Opinion lidhur me lirinë e shprehjes së gjyqtarëve.

2. Opinioni është përgatitur mbi bazën e opinioneve të mëparshme të KKGjE-së, Magna Carta-s së Gjyqtarëve të KKGjE-së (2010) dhe instrumenteve përkatëse të Këshillit të Evropës, sidomos, Kartës Evropiane të Statutit të Gjyqtarëve (1998) dhe Rekomandimit të Komitetit të Ministrave KM/Rek(2010)12, "Gjyqtarët: Pavarësia, Efikasiteti dhe Përgjegjësitë", si dhe raportit të Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) për lirinë e shprehjes së gjyqtarëve (CDLAD(2015)018). Po kështu, ai merr parasysh Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit, Parimet e Bangalorit për Sjelljen e Gjyqësorit dhe raportin e Raportuesit të posaçëm të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, i cili, po ashtu, trajton lirinë e shprehjes së gjyqtarëve[1]. Përveç kësaj, janë marrë parasysh Udhëzimet jodetyruese të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët dhe raportet nga Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë (RrEKGj). Së fundi, Opinioni mbështetet te jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj).

3. Opinioni merr parasysh edhe përgjigjet e anëtarëve të KKGjE-së në pyetësorin mbi lirinë e shprehjes së gjyqtarëve dhe përmbledhjen e këtyre përgjigjeve, si dhe draftin paraprak të përgatitur nga ekspertja e caktuar nga Këshilli i Evropës, znj. Jannika Jahn.

II. Objekti dhe objektivi i Opinionit

4. Opinioni merret lirinë e shprehjes së gjyqtarëve dhe diskuton aspektet kryesore të shprehjes së gjyqësorit. Ai trajton detyrimin ligjor dhe etik të gjyqtarit për të ngritur zërin, me qëllim garantimin e shtetit të së drejtës dhe demokracisë në shkallë vendi, por edhe në atë evropiane dhe ndërkombëtare. Opinioni bën një vlerësim të shprehjes gjyqësore i cili trajton çështjet që lidhen me gjyqësorin, si dhe temat e debatueshme me interes publik dhe shqyrton vetëpërmbajtjen që duhet ushtruar nga gjyqësori. Ai mbulon shprehjen e sistemit gjyqësor brenda dhe jashtë gjykatës. Opinioni synon t'u ofrojë një orientim të përgjithshëm gjyqtarëve dhe një kuadër të gjerë për një diskutim të vazhdueshëm se cilat parametra duhen marrë në konsideratë kur ushtrojnë të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes. Ky Opinion nuk kërkon të përcaktojë fushën minimale të lirisë së shprehjes së gjyqtarëve.

5. Për qëllimet e këtij Opinioni, kushti i vetëpërmbajtjes nga ana e gjyqësorit përkufizohet, për rrjedhojë, si detyrimi për të treguar përmbajtje, i cili i caktohet gjyqtarit ose nga vetë gjyqësori, ose nga ligjvënësi. Për parametrat ligjore, Opinioni mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj). Për pikëpamjet mbi udhëzimet etike dhe rekomandimet e shprehura në këtë Opinion, KKGjE-ja mbështetet te gjetjet e saj. (Vetë)përmbajtja e gjyqësorit përfshin konceptin e maturisë, rezervimit ose të masës.

6. Për trajtimin e lirisë së shprehjes së gjyqtarit individual, Opinioni merr parasysh interesat pjesërisht konkurruese dhe pjesërisht përplotësuese që ngërthen ajo. Ato përfshijnë të drejtën e gjyqtarit për lirinë e shprehjes; të drejtën e publikut për t'u informuar lidhur me çështjet e interesit publik; të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, përfshi një gjykatë të paanshme dhe të pavarur dhe prezumimin e pafajësisë. Po kështu, Opinioni reflekton mbi parimet që qëndrojnë në themel të këtyre të drejtave. Parimi i ndarjes së pushteteve

[1] Raporti i Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, 29 prill 2019, A/HRC/41/48.

është baza e fjalës së lirë të gjyqtarëve, në rast se bëhet fjalë për një çështje me interes publik, siç është funksionimi i sistemit të drejtësisë. Shteti i së drejtës garanton barazinë e të gjithëve (qofshin ata qytetarë apo aktorë shtetërorë) përpara ligjit. Efektiviteti i tij varet pjesërisht nga besimi i publikut te pavarësia dhe autoriteti i gjyqësorit. Ndarja e pushteteve ka nevojë për pavarësinë e gjyqësorit dhe lirinë e shprehjes së gjyqtarëve, çka sjell fërkime midis synimit të moslejimit të gjyqtarëve për t'u sjellë si politikanë dhe, në të njëjtën kohë, mbështetjes së lirisë së tyre të shprehjes si dëshmi e pavarësisë së gjyqësorit.

7. Opinioni trajton edhe rastin kur gjyqtarët flasin ose shkruajnë në emër të shoqatave të gjyqtarëve, gjykatave ose këshillit të gjyqësorit. Kjo nuk përfshin gjyqtarët e dalë në pension, pasi ata gëzojnë të njëjtën liri shprehjeje si të tjerët, përveçse kur bëhet fjalë për informacione të fshehta të përftuara gjatë kryerjes së detyrës.

8. Në rrethanat kur publiku mund të mos e bëjë gjithnjë qartë dallimin se kur një gjyqtar vepron në cilësi personale ose profesionale, Opinioni i konsideron deklaratat e bëra nga gjyqtarët nga pozicioni i tyre si mbajtës të postit publik.

9. Opinioni nuk merret me çështje që kanë të bëjnë me arsyetimin e çështjeve nga gjyqtarët, pasi kjo është përmbushja e detyrës së tyre gjyqësore dhe jo ushtrimi i një të drejte individuale.

10. Për qëllimet e këtij Opinioni, termi "media" përfshin shtypin e shkruar, median e transmetuar dhe atë elektronike, përfshi shërbimet e transmetimit audio dhe video[2].

III. Një vështrim mbi rregullat dhe praktikën e vendeve

11. Përgjigjet e anëtarëve të KKGjE-së për pyetësorin e përgatitjes së këtij Opinioni[3] japin një panoramë të situatës aktuale të rregullave dhe praktikave të vendeve anëtare.

12. Vendet anëtare të Këshillit të Evropës iu garantojnë gjyqtarëve të drejtën e lirisë së shprehjes. Objekti i mbrojtjes ndryshon nga njëri vend anëtar në tjetrin. Në shumë vende, ai përfshin dhënien e mendimeve jashtëgjyqësore, privatisht apo publikisht, lidhur me cilësinë profesionale të gjyqtarit, si dhe deklaratat jashtëgjyqësore që bëhen për llogari dhe në interes të gjyqësorit. Në disa vende, gjyqtarët kanë imunitet nga paditë për çdo gjë që thonë në gjykatë, përveçse kur përcaktohet se është bërë në *mala fides* (keqbesim).

13. Liria e shprehjes e gjyqtarëve është e kufizuar, me qëllim ruajtjen e fshehtësisë së procesit gjyqësor, çështjeve të brendshme gjyqësore dhe të drejtave procedurale të palëve në proces. Në të gjitha vendet anëtare, gjyqtarët ndalohen të japin informacion të fshehtë të përftuar gjatë detyrës, që lidhet me një proces gjyqësor në zhvillim dhe që mund të shkelë të drejtat e palëve në proces. Ata janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional lidhur me diskutimet për marrjen e vendimeve.

14. Në shumicën dërrmuese të vendeve anëtare, gjyqtarët janë objekt i detyrimit ligjor dhe/ose etik[4] të vetëpërmbajtjes, që synon të ruajë pavarësinë e paanshmërinë e gjyqësorit dhe besimin e publikut tek ai, si dhe miradministrimin dhe dinjitetin e gjyqësorit. Rregullat për shprehjen e mendimeve nga gjyqtarët ndryshojnë midis vendeve anëtare.

---

[2] KKGjE-ja merr për bazë përkufizimin e medias, sipas përcaktimit në Shtojcën 1 të Rekomandimit KM/Rek(2022)11 të Komitetit të Ministrave mbi parimet e qeverisjes së medias dhe komunikimit, paragrafi 4.

[3] Shih në https://www.coe.int/en/web/KKGjE/opinion-25-on-the-freedom-of-expression-of-judges.

[4] Për të qenë të saktë, këto kufizime parashikohen në kushtetutë, dispozitat ligjore, kodet e sjelljes, kodet e etikës dhe traditat e gjata gjyqësore.

15. Si rregull apo praktikë të përgjithshme, shumica e vendeve anëtare i ndalojnë ose u bëjnë thirrje gjyqtarëve të mos komentojnë mbi çështjet në gjykim ose në pritje të gjykimit që kanë ata apo gjyqtarët e tjerë. Në disa vende anëtare, ky rregull shtrihet edhe te çështjet gjyqësore për të cilat është marrë vendim, përfshi ato të gjyqtarëve të tjerë. Megjithatë, disa bëjnë një përjashtim të diskutimit të jurisprudencës si pjesë e punës akademike të gjyqtarëve, si profesor i së drejtës ose në një mjedis profesional. Në shumë shtete, gjyqtarët janë objekt i detyrimit etik ose konvencional për të mos iu përgjigjur kritikave publike ndaj çështjeve të tyre gjyqësore.

16. Shkalla në të cilën gjyqtarët mund të marrin pjesë në diskutime publike që lidhen me çështje të interesit politik ose social, me ligjin, gjyqësorin apo administrimin e drejtësisë dhe të shprehin pikëpamjet e tyre për këto çështje në media ndryshon nga njëri vend anëtar në tjetrin. E njëjta gjë vlen për të drejtën e gjyqtarëve për të pasur mandat politik apo për të marrë pjesë në mitingje politike.

17. Në disa vende, gjyqtarëve, përgjithësisht, u kërkohet të mos angazhohen në debate të diskutueshme politike, përfshi mes të tjerash, qortimin në publik të organeve të tjera shtetërore në mënyrë armiqësore apo ndërhyrjen në politikat partiake, duke mbështetur ose kritikuar parti apo politikanë të caktuar. Në vende të tjera anëtare, gjyqtarët duhet të sigurohen që të shmangin dhënien e përshtypjes se kanë një qëndrim të vendosur lidhur me një çështje të caktuar. Disa vende anëtare i lejojnë gjyqtarët të komentojnë publikisht propozimet legjislative apo legjislacionin në përgjithësi, sidomos, kur këto komente i bën shoqata e gjyqtarëve. Edhe nëse lejohet, vendet anëtare raportojnë se gjyqtarët rrallë bëjnë deklarata publike për çështje politike.

18. Në shumicën e vendeve anëtare, gjyqtarët mund të komentojnë mbi çështje që kanë të bëjnë me gjyqësorin, miradministrimin dhe pavarësinë e tij ose ndarjen e pushteteve, me kusht që kritika e tyre të mbështetet mbi fakte dhe argumente dhe që të mos jepet informacion mbi çështjet e brendshme të gjyqësorit. Në disa vende anëtare, shprehja në publik në rrethana të caktuara interpretohet si detyrim etik, veçanërisht, si përgjigje ndaj sulmeve politike kundër gjyqësorit. Për këtë qëllim, gjyqtarëve e gjykatave më të larta u jepet ndonjëherë hapësirë më e madhe veprimi për lirinë e shprehjes. Megjithatë, në disa vende, kjo sjellje ka çuar në kritika publike. Për rrjedhojë, nuk është e pazakontë që gjyqtarëve t'u duhet të shterojnë mekanizmat e brendshme, nëse ekzistojnë në gjyqësor, përpara sesa të flasin në publik apo të heshtin kur gjyqësori synon të nxjerrë një opinion institucional zyrtar.

19. Kritikat në publik për kolegët gjyqtarë ose gjyqësorin kanë qenë burim shqetësimi. Të kritikosh gjyqtarët e tjerë apo aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë, si prokurori apo avokati mbrojtës, në disa shtete anëtare, konsiderohet joetike ose shkelje e një tradite të vendosur prej kohësh, sidomos kur kjo shprehet pa respekt, me ton fyes dhe poshtërues ose nëse përcjell një imazh përgjithësisht negativ të të gjithë gjyqësorit.

20. Në shumicë prej vendeve anëtare që i janë përgjigjur pyetësorit, gjyqtarët nuk duhet të jenë anëtarë të partive politike apo të ndërmarrin veprimtari politike, pasi kjo shihet si diçka që minon pavarësinë e gjyqësorit ose që ndikon negativisht në besimin e publikut te gjyqësori. Në disa raste, rregulli kushtetues apo ligjor i papajtueshmërisë përfshin shprehimisht anëtarësimin në organet legjislative dhe ekzekutive në nivel evropian, kombëtar ose lokal. Për aq kohë sa konsiderohet e papajtueshme me postin e tyre në gjyqësor, disa vende i lejojnë gjyqtarët të mbajnë mandate politike, nëse ikin me leje. Disa prej këtyre vendeve anëtare i vënë gjyqtarët përpara detyrimit etik të ruajtjes së emrit të gjyqësorit. Disa vende i lejojnë gjyqtarët të angazhohet në veprimtari politike paralelisht me ushtrimin e detyrës së tyre gjyqësore. Në këtë rast, ato iu kërkojnë gjyqtarëve të shmangin ndërhyrjen e veprimtarisë së tyre politike në përmbushjen me paanshmëri të detyrave të tyre gjyqësore. Në disa vende gjyqtarët janë objekt i ndalesave

për marrje pjesë në tubime publike, veçanërisht, kur janë me natyrë politike.

21. Përdorimi i medias sociale është temë që përbën shqetësim aktual. Në disa vende anëtare ka një një përdorim në rritje të medias sociale nga gjyqtarët. Megjithatë, pak janë kodet e sjelljes që parashikojnë udhëzime praktike konkrete në këtë drejtim. Nëse e bëjnë, ata zbatojnë detyrimin e përgjithshëm të vetëpërmbajtjes ose bëjnë thirrje për kujdes, për të shmangur shkeljen e pavarësisë, paanshmërisë ose besimit të publikut te gjyqësori.

22. Në pak vende anëtare konstatohet një rritje e kufizimeve ligjore ose etike mbi lirinë e shprehjes së gjyqësorit. Nga ana tjetër, në disa vende anëtare vetëpërmbajtja gjyqësore është zbutur, çka ka çuar në një rritje të angazhimit publik të gjyqtarëve, sidomos në median sociale. Në përgjithësi, shumë vende anëtare shohin nevojën e një diskutimi mbi etikën gjyqësore, duke pasur si një nga detyrat e rëndësishme përcaktimin e përmbajtjes dhe kufizimeve të përshtatshme të lirisë së shprehjes së gjyqtarëve.

23. Janë raportuar disa raste në të cilat gjyqtarët janë përballur me masa disiplinore, për shkak të një deklarate që kanë bërë. Për shembull, deklaratat brenda gjykatës gjatë procesit gjyqësor, që hedhin dyshime mbi paanshmërinë e gjyqtarit, si komentet raciste, kanë çuar në procese disiplinore. Përpara marrjes së masës disiplinore, autoriteti disiplinor i shumicës së vendeve anëtare vlerëson karakterin dhe ashpërsinë dhe rigorozitetin e kufizimit të lirisë së shprehjes, përfshi elemente të tilla si qëndrimi konkret i gjyqtarit, përmbajtja edhe mënyra e deklaratës dhe konteksti në të cilin është bërë, si dhe natyra dhe ashpërsia e masës disiplinore që synon të marrë autoriteti. Heqja e gjyqtarit mund të ndodhë vetëm si hapi i fundit.

IV. Parime të përgjithshme

24. Ashtu siç sanksionohet në Nenin 10 të KEDNj-së, çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur mendime dhe për të marrë dhe për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë.

25. Liria e shprehjes përbën një prej themeleve kryesore të shoqërisë demokratike, një prej kushteve bazë për përparimin e saj dhe për zhvillimin e çdo personi[5]. Për rrjedhojë, përjashtimet nga kjo liri duhen interpretuar në mënyrë rigoroze dhe nevoja për kufizime duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse[6].

26. KKGjE-ja e sheh nga një këndvështrim i gjerë objektin personal të së drejtës së lirisë së shprehjes së gjyqtarëve si një e drejtë individuale[7]. Sipas saj, gjyqtari gëzon të drejtën e lirisë së shprehjes si çdo qytetar tjetër. E drejta e gjyqtarëve për t'u shprehur lirisht shtrihet te mendimet personale të shprehura në lidhje me ushtrimin e detyrës së tyre dhe i lejon gjyqtarët të bëjnë deklarata jashtë gjykate dhe brenda saj, publikisht dhe privatisht, si dhe të angazhohen në debatet publike dhe jetën shoqërore në përgjithësi.

27. Megjithatë, natyra institucionale dhe qeverisëse e postit të gjyqtarit i jep karakter të dyzuar lirisë së shprehjes së një gjyqtari individual. Deklaratat e gjyqtarëve mund të kenë ndikim tek imazhi publik i sistemit të drejtësisë, pasi publiku mund t'i perceptojë ato përgjithësisht jo vetëm si vlerësime subjektive, por edhe si objektive dhe t'ia atribuojë

[5] Shih GjEDNj, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 07.12.1976, Kërkesë nr. 5493/72, § 49.
[6] Shih GjEDNj, *Stoll kundër Zvicrës* [Dhoma e Madhe], 10.12.2007, Kërkesë nr. 69698/01 § 101, e përsëritur në çështjen *Morice kundër Francës* [Dhoma e Madhe], 23.04.2015, Kërkesë nr. 29369/10, § 124.
[7] Shih GjEDNJ-në, *Baka kundër Hungarisë* [Dhoma e Madhe], 23.06.2016, Kërkesa nr, 20261/12; *Wille kundër Lihtenshtajnit* [DhM], 28.10.1999, Kërkesa nr. 28396/95, § 62. Sipas KEDNj-së, përmbushja e mirëfilltë detyrave gjyqësore, d.m.th., deklaratat e bëra në lidhje me detyrat administrative, nuk mbulohen nga liria e shprehjes e parashikuar në Nenin 10 të KEDNj-së, shih *Harabin kundër Sllovakisë*, 20.11.2012, Kërkesa nr. 58688/11 § 151.

ato gjithë institucionit.

28. Në funksionin e tyre zyrtar, gjyqtarët kanë rol me rëndësi në shoqëri, si garantuesit e shtetit të së drejtës dhe drejtësisë[8]. Vetë thelbi i të qenit gjyqtar është aftësia për t'i parë subjektet e mosmarrëveshjeve në mënyrë objektive dhe të paanshme. Po kaq me rëndësi është që gjyqtarët të shihen se e kanë këtë aftësi[9]. Arsyeja për këtë është se ata kanë nevojë për besimin e publikut te pavarësia dhe paanshmëria e tyre, për të përmbushur me sukses detyrat e tyre[10] dhe për të ruajtur autoritetin e gjyqësorit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore apo në përcaktimin e fajësisë apo pafajësisë së individit në raport me një akuzë penale[11]. Që ta bëjnë këtë, gjyqtarët duhet t'i konfirmojnë këto vlera përmes sjelljes së tyre[12]. Për rrjedhojë, është e ligjshme që shteti t'u vendosë gjyqtarëve detyrimin e vetëpërmbajtjes, që i kushton vëmendjen e duhur rolit të tyre në shoqëri[13].

29. Duke pasur parasysh premisat e lartpërmendura, "detyrat dhe përgjegjësitë" e përmendura në Nenin 10(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) marrin domethënie të veçantë për deklaratat e gjyqtarëve[14]. Lidhur me kufizimet ligjore të lirisë së shprehjes së gjyqtarëve, ky nen përcakton se ato duhen parashikuar me ligj dhe janë të nevojshme në një rend ligjor demokratik për t'i shërbyer një qëllimi të ligjshëm. Synimet e ligjshme, sipas përkufizimit në nen, përfshijnë ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit dhe mbrojtjen e fshehtësisë së procesit gjyqësor. Më tej, të drejtat e të tjerëve, si garantimi i prezumimit të pafajësisë, shërbejnë si qëllime të ligjshme për kufizimin e lirisë së shprehjes. Në mungesë të qëllimit të ligjshëm, kufizimi i së drejtës së lirisë së shprehjes së gjyqtarit mund të duket si një hakmarrje e paligjshme kundër gjyqtarit, për shkak të kritikave të padëshiruara[15]. Në shumicën e vendeve anëtare, kufizimet etike ndaj lirisë së shprehjes së gjyqtarëve orientohen nga këto qëllime[16].

30. Kufizimi i fjalës së lirë duhet të jetë i justifikuar. Në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), ndërhyrja konsiderohet e nevojshme në një shoqëri demokratike kur i përgjigjet një "nevoje sociale të ngutshme" dhe është "proporcionale me objektivin e ligjshëm që ndiqet"[17]. Që masa të jetë proporcionale, ajo duhet të jetë masa më pak shtrënguese[18].

31. Prej këtej, nxjerrim si rrjedhim se duhet gjetur ekuilibri midis së drejtës themelore të lirisë së shprehjes së gjyqtarit individual dhe interesit legjitim të shoqërisë demokratike për të

---

[8] Shih Magna Carta-n e KKGjE-së, paragrafi 1; shih gjithashtu GjEDNj-në, *Baka kundër Hungarisë* [DhM], 23.06.2016, Kërkesa nr. 20261/12, § 164.

[9] Shih GjEDNj-në, *Castillo Algar kundër Spanjës*, 28.10.1998, Kërkesa nr. 28194/95, § 45 dhe fjalët e famshme të Presidentit të Gjykatës Supreme, Lord Hewart: "Drejtësia jo vetëm duhet të vendoset, por edhe duhet parë se po vendoset", R. Kundër gjyqtarëve të Sussex-it, *ex parte* McCarthy, (1924) 1 K.B. 256 në 259.

[10] Ashtu siç pranohet edhe nga GjEDNj-ja, shih *Baka kundër Hungarisë* [DhM], 23.06.2016, Kërkesa nr. 20261/12, § 164; *Kudeshkina kundër Rusisë*, 26.2.2009, Kërkesa nr. 29492/05, § 86, *Morice kundër Francës* [DhM], 23.04.2015, Kërkesa nr. 29369/10, § 128-130; *Kyprianou kundër Qipros* [DhM], 15.12.2005, Kërkesa nr. 73797/01, § 172.

[11] GjEDNj, *Morice kundër Francës* [DhM], 23.04.2015, Kërkesa nr. 29369/10, § 129; *Di Giovanni kundër Italisë*, 9.7.2103, Kërkesa nr. 51160/06, § 71.

[12] Shih Rekomandimin e Komitetit të Ministrave KM/Rek(2010)12 për Pavarësinë, Efikasitetin dhe Përgjegjësitë e Gjyqtarëve, paragrafi 21 dhe paragrafi 69 i memorandumit shpjegues. Shih gjithashtu Parimet e Bangalorit për sjelljen gjyqësore, paragrafët 1.6, 2.2, 2.4, 3.2, 4.6; Parimet Bazë të Pavarësisë së Gjyqësorit, parimi 8; Neni 4.3 i Kartës Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve; Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve, Karta Universale e Gjyqtarit (1999, e përditësuar në 2017), Nenet 3- 5, 6-2.

[13] Shih raportin e Komisionit të Venecias për lirinë e shprehjes së gjyqtarëve, CDLAD(2015)018, paragrafët 80–81; GjEDNj, *Baka kundër Hungarisë* [Dhoma e Madhe], 23.06.2016, Kërkesa nr. 20261/12, § 162., edhe për kufirin e vlerësimit që iu është lejuar shteteve.

[14] Shih GjEDNj-në, *Baka kundër Hungarisë* [Dhoma e Madhe], 23.06.2016, Kërkesa nr. 20261/12, § 162.

[15] Shih GjEDNj-në, *Miroslava Todorova kundër Bullgarisë*, 19.10.2021, Kërkesa nr. 40072/13.

[16] *Ashtu si Parimet e Bangalorit, disa prej tyre i referohen dinjitetit të detyrës së gjyqtarit, në vend të autoritetit të gjyqësorit, paragrafi 4.6 i Parimeve të Bangalorit. Për konfidencialitetin, shih paragrafin 4.10 të Parimeve të Bangalorit*

[17] Shih, për shembull, GjEDNj-në, *Baka kundër Hungarisë* [DhM], 23.06.2016, Kërkesa nr 20261/12, paragrafi 158.

[18] Shih GjEDNj-në, *Perinçek kundër Zvicrës* [DhM], 15.10.2015, Kërkesa nr.. 27510/08, § 273.

ruajtur besimin e publikut te gjyqësori[19]. Parimet e Bangalorit formulojnë dy vlerësime themelore në këtë drejtim. I pari lidhet me faktin nëse përfshirja e gjyqtarit ka arsye të minojë besimin në paanshmërinë e tij/saj. I dyti lidhet me faktin nëse kjo përfshirje mund ta ekspozojë gjyqtarin në mënyrë të panevojshme ndaj sulmeve politike ose të mos jetë në pajtim me dinjitetin e detyrës gjyqësore. Nëse është njëri prej këtyre rasteve, gjyqtari duhet ta shmangë këtë përfshirje[20]. Pyetja që duhet ngritur, për pasojë, është nëse në një kontekst të caktuar shoqëror dhe në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm dhe të informuar gjyqtari është angazhuar në një aktivitet, i cili mund të kompromet objektivisht pavarësinë apo paanshmërinë e tij/saj[21]. Kritere të rëndësishme për t'u mbajtur parasysh janë edhe formulimi i deklaratës dhe rrethanat, konteksti dhe sfondi i përgjithshëm në të cilin është bërë deklarata, përfshi qëndrimin e gjyqtarit përkatës[22].

32. Për të arritur në një ekuilibër të arsyeshëm, duhet marrë me kujdes në konsideratë[23] shkalla në të cilën mund dhe duhet të përfshihet në shoqëri gjyqtari. Duhen marrë parasysh se deklaratat publike nga gjyqtari mund të kontribuojnë për mbrojtjen e shtetit të së drejtës dhe ndarjes së pushteteve.

33. Duhen preferuar masa korrigjuese, si përjashtimi apo tërheqja vullnetare e gjyqtarit nga çështja, më shumë sesa shkelja e përgjithshme parandaluese e lirisë së shprehjes së gjyqtarit, që synon të shmangë të tilla situata.

34. Përmbajtja dhe rregullat mbi lirinë e shprehjes dhe kufizimet etike në ushtrimin e detyrës duhet të përcaktohen nga vetë gjyqtarët ose shoqatat e gjyqtarëve[24].

35. Kur vlerësohet një ndërhyrje, duhet shqyrtuar edhe proporcionaliteti i ndëshkimit ose i masave të tjera. Ndëshkimet nuk duhet të kenë "efekt frikësues" për ushtrimin e lirisë së shprehjes nga gjyqtarët e tjerë, d.m.th., ato nuk duhet të frenojnë gjyqtarët e tjerë ta ushtrojnë këtë liri në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë dhe të gjyqësorit[25]. Mendimet e shprehura në përputhje me rekomandimet e këtij Opinioni nuk duhet të jenë objekt i masave disiplinore.

V. Kufizimet e lirisë së shprehjes/ rastet e debatueshme

36. Për t'i ndihmuar gjyqtarët të gjejnë ekuilibrin midis lirisë së shprehjes dhe objektivit të ruajtjes së besimit të publikut te paanshmëria dhe pavarësia e tyre, duhen dhënë orientime lidhur me deklaratat që mund të çojnë në përjashtimin e tyre nga çështja (pikat 1 dhe 2), deklaratat që mund të kenë efekt negativ tek autoriteti dhe emri i gjyqësorit (pikat 3 dhe 4) dhe ushtrimi i mandateve politike, që mund të ngrejë çështje të ndarjes së pushteteve (pika 5).

1. Deklaratat me fokus te mosmarrëveshjet gjyqësore

[19] Shih Opinionin Nr. 3 të KKGjE-së (2002), paragrafët 27 e në vijim, veçanërisht 28, 33. Ekuilibri i vendosur nga GjEDNj-ja ka qenë objekt edhe i vëmendjes së studiuesve, shih mes të tjerash *Anja Seibert-Fohr*, "Liria e shprehjes së gjyqtarëve dhe pavarësia e tyre: një marrëdhënie e dyzuar", 89-110, si dhe, lidhur me përdorimin e medias, *Jannika Jahn*, "Komunikimi nga gjyqtarët në median sociale: vlerësimi i udhëzimeve dhe sfidave të reja për fjalën e lirë dhe detyrat gjyqësore në dritën e Konventës, 137-153, të dyja në librin: *"Rule of Law in Europe - Recent Challenges and Judicial Responses"*, Elósegui/Miron/Motoc (eds.), 2021.

[20] Komentari i Parimeve të Bangalorit, paragrafi 134.

[21] Opinioni Nr. 3 (2002) i KKGjE-së, paragrafi 28.

[22] Shih GjEDNj-në, *Baka kundër Hungarisë* [DhM], 23.06.2016, Kërkesa nr. 20261/12, § 166; *Wille kundër Lihtenshtajnit* [DhM], 28.10.1999, Kërkesa nr. 28396/95, § 63.

[23] Opinioni Nr. 3 (2002) i KKGjE-së, paragrafi 28; Karta Evropiane për statutin e gjyqtarëve, paragrafi 4.3 (komentar shpjegues), përcakton se gjyqtarët nuk bëhen persona të përjashtuar socialë ose civilë.

[24] Shih Udhëzuesin sesi të hartojmë dhe zbatojmë Kodet e Sjelljes Gjyqësore, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin, Vjenë, 2019, f. 14-16.

[25] Shih GjEDNj-në, *Baka kundër Hungarisë* [DhM], 23.06.2016, Kërkesa nr. 20261/12, § 167. Ky ishte rasti me çështjen *Kudeshkina kundër Rusisë*, 26.2.2009, Kërkesa nr. 29492/05, në të cilën gjyqtari kërkues u how nga detyra pasi vuri në pikëpyetje publikisht pavarësinë e gjyqësorit, § 99.

37. KKGjE-ja thekson se gjyqtarët nuk duhet të bëjnë asnjë koment që mund të ndikojë ose pritet në mënyrë të arsyeshme të ndikojë në të drejtën e një procesi të drejtë gjyqësor për çdo person apo çështje që ata kanë në gjykim[26]. Deklaratat e bëra nga gjyqtari mbi një çështje në pritje të gjykimit, përfshi tonin dhe kontekstin e deklaratës, mund të ndikojnë në këtë të drejtë, siç është shprehur edhe GjEDNj-ja[27]. Ajo thekson se, në ushtrimin e funksioneve të tyre gjykuese, gjyqtarët duhet të ushtrojnë rezervim maksimal lidhur me çështjet me të cilat merren, me qëllim që të ruajnë imazhin e paanshmërisë. Gjyqtarët duhet të sillen në mënyrë të tillë që të shmangin përshtypjen se kanë paragjykime personale apo njëanshmëri në një çështje të dhënë. Nëse gjyqtari nënkupton publikisht se ai/ajo ka krijuar tashmë një opinion të pafavorshëm mbi çështjen e paditësit përpara sesa të gjykojë çështjen, deklaratat e tij/saj justifikojnë objektivisht frikën e personit rreth paanshmërisë së tij/saj[28]. Si rrjedhojë e kësaj, KKGjE-ja mbështet kërkesën e përcaktuar në Parimet e Bangalorit se gjyqtari duhet të shfaqë një qëndrim të ftohtë, joparagjykues, të paanshëm, mendjehapur dhe të ekuilibruar në prononcimet e tij/saj publike[29], sidomos nëse ekziston një lidhje e mundshme me një çështje në gjykim apo në pritje të gjykimit.

38. Vetëm fakti që një temë apo çështje mund të jetë objekt i një çështjeje gjyqësore në të ardhmen nuk është i mjaftueshëm për t'i ndaluar gjyqtarët të ushtrojnë të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes, sidomos kur gjasat që një gjyqtar të gjykojë një çështje kaq specifike në të ardhmen janë të pakta.

39. Rritja e vigjilencës kërkohet në kontekstin e hetimeve në proces, sidomos për hetimet penale, me qëllim garantimin e prezumimit të pafajësisë, sanksionuar në Nenin 6(2) of të KEDNj-së[30]. Në proceset penale, gjyqtarët duhet t'iu kushtojnë vëmendje të veçantë fjalëve që zgjedhin, nëse duan të informojnë publikun rreth procesit, përpara sesa një individ të jetë gjykuar dhe të jetë shpallur fajtor për një vepër të caktuar penale[31]. Shpallja e fajësisë së personit të akuzuar përpara procesit gjyqësor bie ndesh me Nenin 6 të KEDNj-së[32].

40. Komentet e gjyqtarëve mbi çështje të tjera gjyqësore për të cilat është marrë vendim, përveç çështjeve të tyre, nuk ngre domosdoshmëri pikëpyetje mbi paanshmërinë e tyre. Komentimi i një rasti jurisprudence lidhet drejtpërdrejt me aktivitetin e tyre profesional. Në aktivitetet e tyre profesionale, gjyqtarët kanë të drejtë të bëjnë komente konstruktive dhe me respekt rreth çështjeve për të cilat është marrë vendim.

41. Gjyqtarët duhet të tregojnë kujdes në raportet e tyre me median dhe të mos shfrytëzojnë personalisht marrëdhëniet me asnjë gazetar[33]. Publikut nuk duhet t'i lihet përshtypje se gjyqtarët duan të ndikojnë në rezultatin përfundimtar të një çështjeje gjyqësore përmes komunikimit në media.

42. KKGjE-ja bie dakord me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) se

---

[26] Shih tashmë në Opinionin Nr. 3 (2002) të KKGjE-së, paragrafi 40, shih Parimet e Bangalorit, paragrafi 2.4.
[27] Shih GjEDNj-në *Olujić kundër Kroacisë*, 5.2.2009, Kërkesa nr. 22330/05, §§ 59 e në vijim; shih *Buscemi kundër Italisë*, 16.9.1999, Kërkesa nr. 29569/95, § 68; *Lavents kundër Letonisë*, 28.11.2002, Kërkesa nr. 58442/00, § 119.
[28] Shih GjEDNj-në *Lavents kundër Letonisë*, 28.11.2002, Kërkesa nr. 58442/00, § 119; *Buscemi kundër Italisë*, 16.9.1999, Kërkesa nr. 29569/95, § 68.
[29] Komentari mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 136, shih edhe paragrafët 45, 65, 71; Parimet e Bangalorit, paragrafët 2.2, 2.4.
[30] Shih GjEDNj-në, *Poyraz kundër Turqisë*, 7.12.2010, Kërkesa nr. 15966/06, §§ 76-78; *Fatullayev kundër Azerbaixhanit*, 22.4.2010, Kërkesa Nr. 40984/07, §§ 159-162; *Lavents kundër Letonisë*, 28.11.2002, Kërkesa nr. 58442/00, §§ 126- 127
[31] Shih edhe GjEDNj-në, *Daktaras kundër Lithuanisë*, 10.10.2000, Kërkesa nr. 42095/98, § 41; *Butkevičius kundër Lituanisë*, 26.3.2002, Kërkesa nr. 48297/99, § 50.
[32] Shih GjEDNj-në, *Previti kundër Italisë* (vendim), 8.12.2009, Kërkesa nr. 45291/06, § 253.
[33] Opinioni Nr. 3 (2002) KKGjE-së, paragrafi 40.

gjyqtarët individualë nuk duhet të përdorin median lidhur me çështjet e tyre gjyqësore, edhe nëse provokohen[34]. Nëse media apo anëtarë të interesuar të publikut kritikojnë një vendim, gjyqtari duhet të shmangë përgjigjen ndaj këtyre kritikave duke shkruar në shtyp apo duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve[35]. Gjyqtari duhet t'u përgjigjet pritshmërive të ligjshme të qytetarëve përmes vendimeve të arsyetuara qartë[36]. Megjithatë, kur gjyqtarët apo vendimet e tyre gjyqësore kritikohen pa të drejtë, shoqatat e gjyqtarëve, këshilli i gjyqësorit dhe/ose kryetari i gjykatës kanë detyrën institucionale të qartësojnë faktet, për të ruajtur imazhin e një gjyqësori kompetent dhe të pavarur edhe në debatet publike. Përveç kësaj dhe në rastet përjashtimore kur gjyqtari përballet me shpifje ose denigrim, ai/ajo duhet të ketë të drejtën të mbrohet dhe të mbrojë integritetin e vet si çdo qytetar tjetër. Në këtë drejtim, gjyqtarët duhet të marrin mbështetje institucionale.

43. Informacioni i fshehtë i përftuar nga gjyqtari në cilësinë e tij/saj zyrtare nuk duhet të përdoret apo të bëhet publik nga ai/ajo për asnjë qëllim që nuk lidhet me detyrat zyrtare të gjyqtarit.

44. Gjyqtarët nuk mund të detyrohen në asnjë rrethanë të shpjegojnë publikisht arsyet e dhënies së vendimeve të tyre gjyqësore.

2. Deklarata në lidhje me debatet publike

45. Parimet e demokracisë, të ndarjes së pushteteve dhe pluralizmit kërkojnë që gjyqtarët të jenë të lirë të marrin pjesë në debate me interes publik[37]. Megjithatë, parimet e ndarjes së pushteteve kërkojnë që gjyqtarët vetë të mos veprojnë si politikanët kur flasin në publik. Kështu, duhet gjetur një ekuilibër i arsyeshëm midis nivelit në të cilin gjyqtarët mund të përfshihen në debate publike dhe nevojës që ata të jenë dhe të shihen si të pavarur dhe të paanshëm në përmbushjen e detyrave të tyre[38]. Përmbajtja dhe konteksti i një deklarate të dhënë merr rëndësi të posaçme në këtë kuptim[39].

46. Për shkak të pozicionit të tyre unik në një demokraci të mbështetur te shteti i së drejtës, gjyqtarët kanë ekspertizën dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej saj për të kontribuar në përmirësimin e ligjit, mbrojtjen e të drejtave themelore, sistemin ligjor dhe administrimin e drejtësisë[40]. Kësisoj, me kusht që të ruajnë paanshmërinë dhe pavarësinë e tyre, ata duhen lejuar e madje edhe nxitur që të marrin pjesë në diskutimet mbi të drejtën për qëllime informimi dhe edukimi[41], si dhe të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre mbi dobësitë në zbatimin e ligjit dhe përmirësimin e tij, si dhe sistemin ligjor.

47. Në të gjitha deklaratat publike për çështjet me interes publik, gjyqtarët duhet të shprehen me kujdes, me një ton të matur, të ekuilibruar dhe me respekt. Ata duhet të shmangin diskriminimin, prozelitizmin ose militantizmin politik, filozofik ose fetar.

3. Deklaratat lidhur me çështjet me interes për gjyqësorin si institucion

48. Gjyqtarët kanë të drejtë të bëjnë komente për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat

---

[34] Për jurisprudencën e GjEDNj-së, shih *Lavents kundër Letonisë*, 28.11.2002, Kërkesa nr. 58442/00, § 118; *Buscemi kundër Italisë*, 16.9.1999, Kërkesa nr. 29569/95, § 67.
[35] Shih komentarin mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 74.
[36] Shih komentarin mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 74.
[37] Shih GjEDNj-në *Previti kundër Italisë* (vend.), 8.12.2009, Kërkesa nr. 45291/06; Shih KKGjE Opinion No. 18 (2015), para 42.
[38] Shih Opinionin Nr. 18 (2015) të KKGjE-së, paragrafi 42; Opinionin Nr. 3 (2002) të KKGjE-së, paragrafët 30 e në vazhdim, veçanërisht paragrafin. 33.
[39] Shih raportin e Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, 29 prill 2019, A/HRC/41/48, paragrafi 42.
[40] Shih komentarin mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 156.
[41] Shih komentarin mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 139.

themelore të njeriut, shtetin e së drejtës, çështjet e emërimeve ose ngritjes në detyrë në gjyqësor dhe funksionimin e duhur të administrimit të drejtësisë, përfshi pavarësinë e gjyqësorit dhe ndarjen e pushteteve[42]. Nëse çështja prek drejtpërdrejt funksionimin e gjykatave, gjyqtarët duhet të jenë të lirë gjithashtu të komentojnë për tema politikisht të diskutueshme, përfshi propozimet legjislative apo politikat qeveritare[43]. Arsyeja për këtë është se publiku ka interes legjitim për t'u informuar rreth këtyre problemeve, duke qenë se prekin çështje shumë të rëndësishme në një shoqëri demokratike[44]. Gjyqtarët në poste drejtuese ose ata që kanë një pozicion në shoqatat e gjyqtarëve apo këshillin e gjyqësorit kanë një pozicion të rëndësishëm për të folur në emër të gjyqësorit.

49. Gjyqtarët kanë të drejtën të bëjnë kërkesa dhe komente lidhur me statusin e tyre, kushtet e punës, si dhe çështje që lidhen me interesat e tyre profesionale. Shoqatat e gjyqtarëve luajnë rol të rëndësishëm për këtë[45].

50. Gjyqtarët duhet të ushtrojnë vetëpërmbajtje[46], për të shmangur kompromettimin e paanshmërisë ose pavarësisë së tyre. Më tej, parashtresat publike që i bëhen qeverisë për çështjet me interes për gjyqësorin nuk duhet të ngjajnë sikur janë lobim me qeverinë apo sikur tregojnë sesi do të vendoste një gjyqtar, nëse një situatë e caktuar do t'i paraqitej në gjykatë. Një gjyqtar i rangut të lartë duhet të jetë posaçërisht i kujdesshëm në këtë pikë, për shkak të pozicionit me rëndësi që ai/ajo mban.

4. Kritikat ndaj gjyqësorit/kolegëve gjyqtarë në publik

51. Sa u takon kritikave në publik apo informacionit mbi çështje që lidhen me gjyqësorin, përfshi komente për kolegët gjyqtarë, KKGjE-ja ndjek linjën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) kur pranon se vetëpërmbajtja e gjyqtarëve zbatohet në të gjitha rastet kur ka të ngjarë që autoriteti dhe paanshmëria e gjyqësorit të vihen në diskutim[47]. Kjo ndodh për arsye se është e nevojshme të mbrohet besimi i publikut nga sulmet dëmtuese, sidomos, duke pasur parasysh faktin se gjyqtarët që përballen me kritika i nënshtrohen detyrimit të vetëpërmbajtjes, që i ndalon të përgjigjen[48].

52. Deklaratat janë të lejueshme, nëse nuk tejkalojnë vetëm kritikat nga një këndvështrim rigorozisht profesional, nëse janë pjesë e një debati mbi çështje me interes të gjerë publik dhe nëse mbështeten në akuza të provuara[49]. Gjyqtarin duhet ta udhëheqë sjellja e matur dhe e përshtatshme edhe në shpërndarjen e informacioneve të sakta[50]. Kur kritikon aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë, gjyqtari duhet të ruajë respektin. Kritikat nuk duhet të jenë të motivuara nga pakënaqësi apo armiqësi personale, apo nga përfitimi personal. Në përgjithësi, gjyqtarët duhet t'i shmangen të shprehurit në mënyrë impulsive, të papërgjegjshme dhe fyese.

53. Është me rëndësi që gjyqësori të ofrojë një atmosferë e cila i lejon gjyqtarët të bëjnë komente kritike, sidomos në një gjyqësor të organizuar në formë hierarkike, ku gjyqtarët

---

[42] Shih raportin e Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, 29 prill 2019, A/HRC/41/48, paragrafi 69; shih edhe komentarin mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 138; Opinioni Nr. 3 (2002) i KKGjE-së, paragrafët 33-34.
[43] Shih komentarin mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 138.
[44] Shih GjEDNj-në *Baka kundër Hungarisë* [GC], 23.06.2016, Kërkesa nr. 20261/12, § 165.
[45] Opinioni Nr 23 (2020) i KKGjE-së.
[46] Komentari mbi Parimet e Bangalorit për Sjelljen e Gjyqësorit, paragrafi 138.
[47] Shih GjEDNj-në, *Kudeshkina v. Russia*, 26.2.2009, Kërkesa nr. 29492/05, § 86; *Di Giovanni kundër Italisë*, 9.7.2103, Kërkesa nr. 51160/06, § 71; *Panioglu kundër Rumanisë*, 8.10.2020, Kërkesa nr. 33794/14, § 114.
[48] Shih GjEDNj-në, *Morice kundër Francës* [DhM], 23.04.2015, Kërkesa nr. 29369/10, § 128.
[49] Shih GjEDNj-në, *Baka kundër Hungarisë* [DhM], 23.06.2016, Kërkesa nr. 20261/12, § 171; *Panioglu kundër Rumanisë*, 8.10.2020, Kërkesa nr. 33794/14, § 119; *Kudeshkina kundër Rusisë*, 26.2.2009, Kërkesa nr. 29492/05, § 93.
[50] Shih GjEDNj-në, *Kudeshkina kundër Rusisë*, 26.2.2009, Kërkesa nr. 29492/05, § 93.

varen nga kolegët e rangjeve më të larta, duke qenë se ata kontribuojnë në rritjen e tyre në detyrë. Megjithatë, gjyqtarët duhet së pari të shfrytëzojnë të gjitha zgjidhjet efektive ekzistuese, përpara sesa të flasin publikisht.

5. Mandati politik aktiv/mandati i mëparshëm politik

54. Përfshirja e drejtpërdrejtë në politikën partiake mund të ngrejë dyshime mbi ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë ose paanshmërinë e një gjyqtari, çka është arsyeja se pse shumë vende e kufizojnë veprimtarinë politike të gjyqtarëve. Me qëllim garantimin e të drejtave të qytetarëve në kuadër të Nenit 6 të KEDNj-së, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) e pranon si proporcionale që vendet të përjashtojnë gjyqtarët nga mbajtja e posteve politike[51]. Komentari mbi Parimet e Bangalorit shprehet se detyrat gjyqësore janë të papajtueshme me veprimtari të caktuara politike, si të qenit anëtr i parlamentit kombëtar apo i këshillave vendore[52].

55. KKGjE-ja bashkohet me GjEDNj-në kur konstaton se, të kesh qenë më parë pjesë e një partie politike, nuk është mjaftueshëm për të hedhur dyshime mbi paanshmërinë e një gjyqtari, sidomos kur nuk ka asnjë të dhënë që anëtarësia ka ndonjë lidhje me thelbin e çështjes[53].

56. Sidoqoftë, për të mbrojtur besimin e publikut te gjyqësori, standardet bazë të sjelljes gjyqësore, si ruajtja e emrit të gjyqësorit, duhet të vazhdojnë të zbatohen kur gjyqtari mban një mandat politik[54]. Nëse gjyqtarët kanë shkelur standardet e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore, përmes dhënies së deklaratave të caktuara gjatë aktivitetit të tyre politik, ata duhet të vetëpërjashtohen nga çështjet gjyqësore ku çështjet përkatëse marrin rëndësi. Për të ruajtur mundësinë e rimarrjes së funksionit të tyre gjyqësor, është e domosdoshme që ata të shmangin dhënien e deklaratave që i bëjnë të duken të papërshtatshëm për postin gjyqësor.

57. Në vendet ku gjyqtarët mund të mbajnë një mandat politik (me kohë të pjesshme) ose të jenë anëtarë të një partie politike, përveç postit të tyre gjyqësor, ata duhet të shfaqin vetëpërmbajtje, me qëllim që të mos komprometojnë pavarësinë ose paanshmërinë e tyre[55]. Është e domosdoshme që ata të shmangin mbajtjen e qëndrimeve ngushtësisht partiake dhe të forta ndaj çdo problemi apo çështjeje politike që ngre dyshime të arsyeshme mbi aftësinë e tyre të përgjithshme për të marrë vendime mbi këto çështje në mënyrë objektive.

VI. Mbrojtja e pavarësisë së gjyqësorit si detyrim ligjor dhe/ose etik i gjyqtarëve, shoqatave të gjyqtarëve dhe këshillave të gjyqësorit

58. Në përputhje me Opinionet e saj Nr. 3 (2002)[56] dhe Nr. 18 (2015)[57], KKGjE-ja përcakton se çdo gjyqtar është përgjegjës për nxitjen dhe mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit, që funksionon jo vetëm si garanci kushtetuese për gjyqtarin, por edhe i vendos gjyqtarit detyrimin etik dhe/ose ligjor për ta ruajtur e për të ngritur zërin në mbrojtje të shtetit të së drejtës dhe pavarësie së gjyqësorit, kur këto vlera themelore kërcënohen[58]. Ai

[51] Shih GjEDNj-në, *Briķe kundër Letonisë*, 29.6.2000, Kërkesa nr. 47135/99.
[52] Komentari mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 135.
[53] Shih GjEDNj-në, *Otegi Mondragon dhe të tjerët kundër Spanjës* (vend.), 6.11.2018, Kërkesa nr. 4184/15 (e të tjerë).
[54] Shih GjEDNj-në, *Kudeshkina kundër Rusisë*, 26.2.2009, Kërkesa nr. 29492/05, §§ 85 e në vijim; në këtë çështje, gjyqtarja u pezullua nga funksioni i saj gjyqësor në pritje të zgjedhjeve, ku ajo ishte në garë si kandidate.
[55] Shih Opinionin Nr. 3 (2002) të KKGjE-së, paragrafët 30, 33; shih edhe raportin e Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, 29 prill 2019, A/HRC/41/48, paragrafi 66.
[56] Opinioni Nr. 3 (2002) i KKGjE-së, paragrafi 34.
[57] Opinioni Nr. 18 (2015) i KKGjE-së, paragrafi 41.
[58] GjEDNj, *Żurek kundër Polonisë*, 10.10.2022, Kërkesa nr. 39650/18, § 222; raporti i Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, 29 prill 2019, A/HRC/41/48, paragrafi 102;

përfshin çështje të pavarësisë së brendshme dhe të jashtme.

59. Duke pasur parasysh bashkëpunimin evropian dhe ndërkombëtar për çështjet ligjore dhe rëndësinë e së drejtës evropiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit, gjyqtarët mund t'i trajtojnë kërcënimet ndaj pavarësisë së gjyqësorit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

60. Nëse pavarësia gjyqësore ose aftësia e pushtetit gjyqësor për të ushtruar rolin e tij kushtetues kërcënohen ose sulmohen, gjyqësori duhet të shfaqë rezistencë dhe ta mbrojë pa frikë qëndrimin e tij[59]. Kjo detyrë lind veçanërisht kur demokracia është një situatë keqfunksionimi, në të cilën shpërbëhen vlerat themelore dhe sulmohet pavarësia gjyqësore.

61. Duke qenë se detyra për t'u mbrojtur rrjedh nga pavarësia e gjyqësorit, ajo vlen për çdo gjyqtar[60]. Kur gjyqtari bën deklarata të tilla jo vetëm në cilësinë e tij/saj personale, por edhe në emër të këshillit gjyqësor, shoqatës së gjyqtarëve apo një organizmi tjetër përfaqësues të gjyqësorit, mbrojtja që i jepet këtij gjyqtari do të forcohet.[61] Duke e marrë këtë parasysh dhe në varësi të çështjes dhe kontekstit, këshilli i gjyqësorit[62], shoqatat e gjyqtarëve[63], kryetarët e gjykatave dhe organet e tjera të pavarura mund të jenë vendet më të mira për t'i trajtuar këto çështje, për shembull, çështjet e nivelit të lartë kushtetues. Po ashtu, gjyqtarët mund të shprehin pikëpamjet e tyre edhe në kuadrin e shoqatës ndërkombëtare të gjyqtarëve.

62. Megjithatë, nëse ndonjë prej këtyre çështjeve do të paraqitej në gjykatë përpara gjyqtarit dhe, nëse paanshmëria e gjyqtarit do të vihej në mënyrë të arsyeshme në diskutim, gjyqtari duhet të vetëpërjashtohet nga çdo proces[64].

VII. Detyrimi etik i gjyqtarëve për t'i shpjeguar drejtësinë publikut

63. Gjyqtarët duhet të përpiqen të nxitin dhe të ruajnë besimin e publikut në veprimtarinë gjyqësore, duke e bërë atë më të kuptueshëm dhe transparent dhe duke ndihmuar në shmangien e keqinterpretimeve në publik[65]. KKGjE-ja e mbështet qëndrimin e marrë në Parimet e Bangalorit se gjyqtarët duhet të synojnë të informojnë publikun për atë çka nënkupton pavarësia e gjyqësorit[66]. Gjyqtarët duhet të shpjegojnë më tej punën e gjyqësorit, përfshi detyrat dhe kompetencat e gjyqtarëve. Ata duhet të hedhin dritë mbi rolin e gjyqësorit dhe marrëdhëniet e tyre me pushtetet e tjera shtetërore. Në përgjithësi, ata duhet të ilustrojnë sesi funksionojnë vlerat e sistemit të drejtësisë në praktikë[67].

64. Deri më tani, KKGjE-ja është përqendruar në rolin edukues të gjykatave dhe shoqatave të gjyqtarëve, sepse ato janë veçanërisht të mirëpozicionuara për ta marrë përsipër këtë rol[68]. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka inkurajuar krijimin e zëdhënësve të

Asambleja e Përgjithshme e RrEKGj-së, Deklarata e Sofjes 2013, paragrafi vii; Komentari mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 140, Shih edhe Magna Carta-n e gjyqtarëve, e KKGjE-së, paragrafi 3.

[59] Opinioni Nr. 18 (2005) i KKGjE-së, paragrafi 41.

[60] GjEDNj, *Żurek kundër Polonisë*, 10.10.2022, Kërkesa nr. 39650/18, §222.

[61] GjEDNj, *Żurek kundër Polonisë*, 10.10.2022, Kërkesa nr. 39650/18, § 222.

[62] Misioni i tyre është të garantojnë pavarësinë e gjyqtarit individualisht dhe të gjyqësorit dhe të mbrojnë shtetin e së drejtës, Opinioni Nr. 23 (2020) i KKGjE-së, paragrafi 29; shih edhe Opinionin Nr. 7 (2005) të KKGjE-së, C.13.

[63] Në përgjithësi, shoqatat e gjyqtarëve kanë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit në debatin publik, shih Opinionin Nr. 23 (2020) të KKGjE-së, paragrafi 17.

[64] Shih Komentarin mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 140.

[65] Shih Opinionin Nr. 7 (2005) të KKGjE-së, paragrafët 6-23; shih edhe RrEKGj-në, "Justice Society and the Media", raporti i vitit 2011-2012.

[66] Komentari mbi Parimet e Bangalorit, paragrafi 44.

[67] Shih edhe Raportin e RrEKGj-së për besimin e publikut dhe imazhin e drejtësisë (2018-2019), Kapitulli V, 5.3

[68] Opinioni Nr. 23 (2020) i KKGjE-së, paragrafët 44-46; Opinioni Nr. 18 (2015) i KKGjE-së, paragrafi 32; Opinioni Nr.7 (2005) i KKGjE-së, paragrafët 6-23.

gjykatave ose shërbimeve të medias dhe komunikimit në varësi të gjykatave, këshillave të gjyqësorit apo çdo organi tjetër të pavarur[69]. Rrjeti Evropian i Këshillave të Gjyqësorit (RrEKGj) vëren se gjyqtarët individualë duhet të hezitojnë të shfaqen si zëdhënës në media[70].

65. KKGjE-ja është e mendimit se gjyqtarët individualë me aftësi të përshtatshme komunikimi munden po ashtu të shpjegojnë funksionimin dhe vlerat e gjyqësorit[71]. Përveç forumeve edukative[72], ata mund të përdorin median, përfshi median sociale, si një instrument të shkëlqyer për të komunikuar dhe edukuar publikun[73]. Në të tilla raste, gjyqtarët duhet të përgatiten në mënyrë tërësore, në bashkëpunim me gjyqtarët e emëruar për t'u kujdesur për marrëdhëniet me median ose zyrtarët për informimin e publikut[74] dhe të jenë të kujdesshëm t'i respektojnë detyrimet e vetëpërmbajtjes gjyqësore, duke u shprehur në mënyrë asnjanëse dhe të paanshme[75].

VIII. Përdorimi i medias sociale nga gjyqtarët

1. Liria e shprehjes e gjyqtarëve në internet dhe jashtë tij

66. Është gjerësisht e pranuar se të drejtat që njerëzit kanë jashtë internetit janë njësoj të mbrojtura edhe në internet, veçanërisht, liria e shprehjes. Në varësi të sa më poshtë, gjyqtarët mund ta përdorin median sociale si çdo qytetar tjetër[76].

2. Hartimi i udhëzimeve për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët

a) Përkufizimi i medias sociale

67. KKGjE-ja i referohet kuptimit të përgjithshëm të konceptit të media[s sociale si forma komunikimi elektronik (si faqet e internetit për krijimin e rrjeteve sociale dhe mikroblogjet) përmes të cilave, përdoruesit krijojnë komunitete në internet për të shkëmbyer informacione, ide, mesazhe personale dhe përmbajtje të tjera (si video). Në vijim të Rekomandimit KM/Rek(2022)11 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për parimet qeverisëse të medias dhe komunikimit, Opinioni përdor një koncept të gjerë të medias dhe i kualifikon platformat si shërbime digjitale që lidhin pjesëmarrësit në tregje shumëpalëshe dhe caktojnë rregullat për këto ndërveprime dhe përdorin sistemet algoritmike për të mbledhur dhe analizuar të dhënat e për të personalizuar shërbimet e tyre[77].

b) Zbatueshmëria e rregullit të përgjithshëm të vetëpërmbajtjes gjyqësore

68. Instrumentet ndërkombëtare nuk përmbajnë shumë orientime për mënyrën sesi gjyqtarët duhet ta ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes në internet. Një përfundim i përbashkët, që KKGjE-ja e mbështet, është se gjen zbatim detyrimi i përgjithshëm i

[69] Shih Rekomandimin e Komitetit të Ministrave CM/Rec(2010)12 për Gjyqtarët: Pavarësia, Efikasiteti dhe Përgjegjësitë, paragrafi 19; Shih Udhëzuesin e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) për Komunikimin me Median dhe Publikun për Autoritetet e Gjykatave dhe Prokurorive, CEPEJ(2018)15 dhe Opinionin Nr. 7 (2005) të KKGjE-së, paragrafët 33 e në vijim.
[70] RrEKGj, Raporti 2011-2012, paragrafi 6.2.6.
[71] Shih RrEKGj, Raporti 2018-2019, Kapitulli V, 5.3.
[72] Shih Komentarin mbi Parimet e Bangalorit, paragrafët 156-157.
[73] Shih Raportin e Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, 29 prill 2019, A/HRC/41/48, paragrafi 77; Udhëzimet Jodetyruese të UNODC-së për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët, paragrafët 1, 8; Shih RrEKGj, Raporti 2018-2019, Kapitulli II, 2.1.
[74] Shih RrEKGj, Raporti 2011-2012, paragrafi 6.2.6.
[75] Shih Udhëzimet Jodetyruese të UNODC-së për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët, paragrafi 1.
[76] Për zbatimin e Nenit 10 të KEDNj-së në komunikimin elektronik, shih GjEDNj-në, *Delfi AS kundër Estonisë* [DhM], 16.6.2015, Kërkesa nr. 64569/09, § 110; *Kozan kundër Turqisë*, 1.3.2022, Kërkesa nr. 16695/19.
[77] Shih Shtojcën e Rekomandimit KM/Rek(2022)11 të Komitetit të Ministrave mbi parimet e qeverisjes së medias dhe komunikimit, paragrafi 4.

vetëpërmbajtjes gjyqësore[78]. Kjo nënkupton se gjyqtarët duhet të shmangin shprehjen e pikëpamjeve apo ndarjen e informacioneve personale në internet, që mund të minojnë pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore, të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor ose dinjitetin e detyrës dhe (besimin e publikut në) autoritetin e gjyqësorit. Për këtë qëllim, gjyqtarët duhet të tregojnë kujdes në përdorimin e medias sociale nga ana e tyre[79]. Ashtu siç është shprehur Raportuesi i posaçëm i Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, zbatimi i vetëpërmbajtjes gjyqësore në komunikimet në median sociale nuk do të thotë që gjyqtarëve u duhet të tërhiqen nga jeta publike që zhvillohet në median sociale[80].

69. Me disa përjashtime, komunikimi privat nuk duhet t'u nënshtrohet kufizimeve të lirisë së shprehjes. Komunikimi privat kuptohet se ndodh mbi baza dypalëshe apo në një grup të mbyllur, ku hyhet me lejen e gjyqtarit, përfshi shërbimet e mesazheve individ me individ apo grupet e mbyllura të platformave sociale.

c) Përshtatja e sjelljes gjyqësore me sfidat specifike të komunikimit në median sociale

70. Përdorimi i medias sociale ngre sfida dhe shqetësime etike të reja që kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e përmbajtjes së postuar dhe me shfaqjen e njëanshmërisë ose interesit. Media sociale ka si tipar aksesin dhe përcjelljen me bazë të gjerë, që nënkupton ndjekje më të madhe të përmbajtjes së postuar. Media sociale ka kapacitet ruajtës të përhershëm, çka rrit rrezikun e profilizimit. Ajo përmban komunikime personale në formë të shkruar, duke rritur rrezikun e publikimit pa leje të mesazheve personale, si dhe rrezikun e shtrembërimit të në komunikimet vijuese[81]. Komunikimi është i shpejtë dhe i synuar, çka mund t'i nxitë gjyqtarët të publikojnë postime të pakujdesshme. Veprime si "pëlqimi" ose përcjellja e informacionit të paraqitur nga të tjerë mund të duken gjëra relativisht të vogla dhe rastësore, por ato cilësohen si shprehje të mirëfillta të mendimit të gjyqtarit[82]. Ndryshe nga media tradicionale, medias sociale i mungon rojtari, çka i lejon gjyqtarët të publikojnë çdo gjë që iu shkon nëpër mend.

71. Këto rreziqe specifike kërkojnë që gjyqtari të ushtrojë kujdes të veçantë në komunikimet e tij/saj në median sociale[83]. KKGjE-ja vëren një rrezik të madh që ndarja e përmbajtjes personale mund të ndikojë negativisht imazhin e gjyqtarit ose të të gjithë gjyqësorit[84]. Për rrjedhojë, gjyqtarët nuk duhet të angazhohen në faqet e medias sociale apo shërbimet e shkëmbimit të mesazheve në shkëmbime me palët, përfaqësuesit e tyre ose publikun e përgjithshëm lidhur çështjet gjyqësore që kanë ose ka të ngjarë të kenë për të marrë vendim[85]. Ata duhet të tregohen të kujdesshëm lidhur me rrezikun e keqinterpretimit të përfshirjes së deklaratave në grupe të mbyllura. Ata duhet të jenë të matur në krijimin e një "profili" përmes komenteve të tyre që japin përshtypjen se ai nuk është mendjehapur apo objektiv lidhur me tema të caktuara. E njëjta gjë vlen edhe për grupet e platformave sociale ku ata hyjnë apo njerëzit që ndjekin dhe komentet që "pëlqejnë" ose "ripostojnë në *Twitt*er", duke qenë se sa më të njëanshme të jenë ato, aq

[78] Shih Udhëzimet Jodetyruese të UNODC-së për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët, paragrafët 1, 15; Raporti i Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, 29 prill 2019, A/HRC/41/48, paragrafët 78, 81; Shih Rekomandimin e Komitetit të Ministrave KM/Rek(2010)12 për Gjyqtarët: Pavarësia, Efikasiteti dhe Përgjegjësitë, paragrafi para 19.
[79] Shih Opinion Nr. 3 (2002) të KKGjE-së, paragrafi 40, lidhur me marrëdhëniet me shtypin.
[80] Raporti i Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, 29 prill 2019, A/HRC/41/48, paragrafi 79.
[81] Raporti i Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, 29 prill 2019, A/HRC/41/48, paragrafi 81; Shih Raportin 2018-2019 të RrEKGj-së, Kapitulli II, 2.1.
[82] Shih Udhëzimet Jodetyruese të UNODC-së për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët, paragrafi 6.
[83] Shih Raportin e Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, 29 prill 2019, A/HRC/41/48, para 81.
[84] Shih Raportin 2018-2019 të RrEKGj-së, Kapitulli II, 2.1.
[85] Shih Udhëzimet Jodetyruese të UNODC-së për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët, paragrafi 17.

më shumë njerëzit mund t'i perceptojnë këta gjyqtarë si jo të pavarur dhe të paanshëm[86]. Kur përfshihen në një diskutim lidhur me punën e tyre si gjyqtarë, mbrojtja e autoritetit dhe dinjitetit të detyrës duhet t'i shkurajojnë gjyqtarët të bëjnë komente që vënë në pikëpyetje përshtatshmërinë e tyre në kryerjen e detyrave të tyre.

72. Gjyqtarët duhet të sigurohen të ruajnë autoritetin, integritetin, etiketën dhe dinjitetin e detyrës gjyqësore[87]. Ata duhet të jenë të vëmendshëm ndaj faktit se gjuha, veshja, fotot dhe zbulimi i të dhënave të tjera personale mund të cenojë imazhin e gjyqësorit. Të lejosh që gjyqtarët të ndajnë informacione private si mënyra e jetesës apo familja mbart disa rreziqe në këtë drejtim. Nëse një shprehje ka të ngjarë të kompromet ojë emrin e gjyqtarit ose të gjyqësorit, ajo duhet vlerësuar në dritën e rrethanave të rastit.

73. Gjyqtarët nuk duhet të angazhohen në median sociale në një mënyrë që ndikon negativisht në perceptimin e integritetit gjyqësor nga ana e publikut, p.sh., të sillen si influencues.

74. Gjyqtarët duhet të marrin në konsideratë nëse përmbajtja e papërshtatshme digjitale që i paraprin emërimit të tyre në gjyqësor mund të dëmtojë besimin e publikut në paanshmërinë e tyre ose të cenojë imazhin e gjyqësorit. Nëse është kështu, ata duhet ta heqin këtë përmbajtje, nëse është e mundur, në përputhje me rregullat në fuqi të juridiksionit të tyre[88].

d) Sugjerimi i përdorimit transparent të medias sociale (me miratim)

75. Detyra e vetëpërmbajtjes gjyqësore vlen për komunikimin në median sociale, pavarësisht nëse gjyqtarët e zbulojnë ose jo identitetin e tyre[89]. Nuk ka asnjë bazë që ndalon gjyqtarët të përdorin pseudonime. Megjithatë, pseudonimet nuk lejojnë sjelljen joetike. Më tej, mospërmendja e detyrës gjyqësore ose përdorimi i një pseudonimi nuk garanton që emri i vërtetë ose statusi gjyqësor nuk do të bëhen publikë. Vënia e një shënimi për mosmarrje përgjegjësie në profilet e medias sociale se e gjithë përmbajtja dhe mendimet e shprehura aty janë në cilësi personale nuk e çlirojnë gjyqtarin nga ushtrimi i vetëpërmbajtjes.

e) Theksimi i rëndësisë së trajnimit të gjyqtarëve për përdorimin e medias sociale

76. KKGjE-ja thekson rëndësinë e trajnimit të të gjithë gjyqtarëve për aplikacionet e medias sociale dhe efektet etike të përdorimit të tyre në kontekstin personal dhe profesional[90].

77. Kjo duhet t'i ndihmojë gjyqtarët të kuptojnë se deri në ç'pikë duhet të jenë të rezervuar që të mbrojnë sigurinë e tyre dhe të përmbushin detyrimet që kanë për ruajtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë, dinjitetit të detyrës së tyre dhe besimit të publikut te gjyqësori. Një fushë e përshtatshme për trajnimin e gjyqtarëve do të ishte të mësonin se cilat janë platformat e medias sociale në përdorim, si funksionojnë mediat e ndryshme sociale, ç'lloj informacioni mund të ishte i përshtatshëm për t'u ndarë në platforma të ndryshme të medias sociale dhe cilat janë rreziqet dhe pasojat e mundshme që ka pjesëmarrja në këto platforma komunikimi. Trajnimi duhet të mbulojë aspekte teknike (si konfigurimet e ndryshme të privatësisë të platformave të ndryshme sociale), aspekte të

---

[86] Shih Udhëzimet Jodetyruese të UNODC-së për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët, paragrafi 18.

[87] Shih Udhëzimet Jodetyruese të UNODC-së për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët, paragrafi 5 dhe 18.

[88] Shih Udhëzimet Jodetyruese të UNODC-së për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët, paragrafi 21.

[89] Shih edhe Udhëzimet Jodetyruese të UNODC-së për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët, paragrafi 16. Me kusht që kjo të mos shkelë standardet etike në fuqi apo rregullat ekzistuese që ndalojnë identifikimin e gjyqtarit si anëtar i gjyqësorit në median sociale. Shih paragrafët 12-13.

[90] Shih, po ashtu, Raportin e RrEKGj-së 2018-2019, Kapitulli II, 2.7; Raportin e RrEKGj-së 2011-2012, 6.2.4; Udhëzimet Jodetyruese të UNODC-së për përdorimin e medias sociale nga gjyqtarët, paragrafët 14, 38-40; Shih Opinionin Nr. 23 (2020) të KKGjE-së, paragrafi 18; KKGjE, Magna Carta, paragrafi 18.

profilizimit dhe mbrojtjes së të dhënave.

78. Gjyqësori duhet t'u ofrojë trajnime të vazhdueshme gjyqtarëve të sapoemëruar dhe gjyqtarëve të rinj. Shoqatat e gjyqtarëve mund të kontribuojnë për trajnimin, shkëmbimin dhe ndarjen e njohurive dhe praktikave më të mira midis gjyqtarëve.

IX. Rekomandime

1. Gjyqtari gëzon të drejtën e lirisë së shprehjes si çdo qytetar tjetër. Përveç të drejtave individuale të gjyqtarit, parimet e demokracisë, ndarjes së pushteteve dhe pluralizmit kërkojnë që gjyqtarët të jenë të lirë të marrin pjesë në debate me interes publik, sidomos sa u takon çështjeve që kanë të bëjnë me gjyqësorin.

2. Në situatat kur demokracia, ndarja e pushteteve, shteti i së drejtës gjenden nën kërcënim, gjyqtarët duhet të jenë të palëkundur dhe kanë detyrimin të ngrenë zërin në mbrojtje të pavarësisë së gjyqësorit, rendit kushtetues dhe rivendosjes së demokracisë, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Kjo përfshin edhe mendimet dhe pikëpamjet mbi çështje me ndjeshmëri politike dhe mbulon pavarësinë e brendshme dhe të jashtme të gjyqtarëve individualë dhe të gjyqësorit në tërësi. Gjyqtarët që flasin në emër të këshillit gjyqësor, shoqatës së gjyqtarëve apo organeve të tjera përfaqësuese të gjyqësorit gëzojnë liri veprimi më të madhe në këtë drejtim.

3. Përveç shoqatave të gjyqtarëve, këshillave të gjyqësorit apo çdo organi tjetër të pavarur, gjyqtarët individualë kanë detyrimin etik për t'i shpjeguar publikut sistemin e drejtësisë, funksionimin e gjyqësorit dhe vlerat e tij. Duke rritur kuptimin, transparencën dhe duke e ndihmuar publikun të shmangë keqinterpretimet, gjyqtarët mund të ndihmojnë për nxitjen dhe ruajtjen e besimit të publikut tek aktiviteti i gjyqësorit.

4. Gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes, gjyqtarët duhet të mbajnë parasysh përgjegjësitë dhe detyrat konkrete që kanë në shoqëri dhe të ushtrojnë vetëpërmbajtje në shprehjen e pikëpamjeve dhe mendimeve të tyre në çdo rrethanë ku, në sytë e vëzhguesit të arsyeshëm, deklarata e tyre mund të komprometojë pavarësinë ose paanshmërinë e tyre, dinjitetin e detyrës së tyre ose të rrezikojnë autoritetin e gjyqësorit. Në veçanti, ata duhet të mos bëjnë komente mbi thelbin e çështjeve gjyqësore me të cilat merren. Po ashtu, gjyqtarët duhet të ruajnë fshehtësinë e procesit gjyqësor.

5. Si parim i përgjithshëm, gjyqtarët duhet të shmangin përfshirjen në kundërshti publike. Edhe në rastet kur lejohet anëtarësimi i tyre në një parti politike apo pjesëmarrja në debate publike, gjyqtarët duhet t'i shmangen çdo aktiviteti politik që mund të komprometojë pavarësinë ose paanshmërinë e tyre ose imazhin e gjyqësorit.

6. Gjyqtarët duhet të jenë të ndërgjegjshëm si për përfitimet, ashtu edhe për rreziqet e komunikimit në media. Për këtë arsye, gjyqësori duhet t'u ofrojë gjyqtarëve trajnime për t'i edukuar për përdorimin e medias, që mund të shfrytëzohet si një instrument i shkëlqyer për t'u lidhur me publikun. Në të njëjtën kohë, duhet rritur ndërgjegjësimi se kur postohet në median sociale, gjithçka që publikohet bëhet e përhershme, edhe pasi fshihet dhe mund të interpretohet lirisht ose edhe të nxirret jashtë kontekstit. Pseudonimet nuk mbulojnë sjelljen joetike në internet. Gjyqtarët duhet të mos postojnë asgjë që komprometon besimin e publikut në paanshmërinë e tyre apo që bie ndesh me dinjitetin e detyrës së tyre ose të gjyqësorit.

7. Rregullat ose kodet e sjelljes që kanë të bëjnë me shkallën e lirisë së shprehjes dhe çdo kufizim të ushtrimit të saj duhen hartuar nga vetë gjyqtarët ose shoqatat e tyre të gjyqtarëve.